ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

E Enjte, 18 qershor 2015
14:00h

Procesverbali

I vizitës monitoruese në mbikëqyrjen e punimeve në ndërtimin e HC-ve, Belaja dhe Deçan sipas vendimit V-402-2012 të Bordit të ZRRE-së

Të pranishëm:

Andrea Fritz, përfaqësues i KelKos Energy SH.P.K.
Krenar Bujupi, Anëtar i Bordit
Afrim Ajvazi, DLL
Ymer Fejzullahu, DTÇ
Ymridin Misini, DLL

Fillimisht z. Andrea Fritz, ka hapur takimin duke falënderuar që kemi gjetur kohet për të monitoruar ndërtimin e HC-ve në Lumëbardhin e Deçanit, si dhe na ka njoftuar se z. George Woeber, Dretor i KelKos Energy SH.P.K., nuk ka mundur të na bashkëngjitet pasi që gjendet në Austri, dhe ka shprehur dëshirën që të zhvillohet një bisedë përmes Scype, për të na njoftuar më tepër rreth realizmit të projektit.

Z. Bujupi ka falënderuar përfaqësuesin e KelKos Energy SH.P.K., për pritjen dhe ka njoftuar arsyen e ardhjes në këtë vizitë monitoruese. Ka sqaruar se Bordi i ZRRE-së, përveç kompetencave tjera funksionale të përcaktuar me Ligjin për Rregullatorin për Energji ka mandat edhe për lëshimin e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese si dhe monitorimin e realizimit të projekteve. Arsyeja e ardhjes në këtë vizitë monitoruese është se nga shoqëria KelKos Energy SH.P.K., kemi pranuar kërkesën për zgjatje të afatit të vendimit V-402-2012 të datës 15 qershor 2012.

z. Andrea Fritz theksoi se z. George Woeber është në pritje të zhvillimit të bisedës përmes Scype. Z. George Woeber fillimisht kërkoi falje që nuk ka mundur të na bashkëngjitet me arsyetimin që gjendet jashtë vendit me kërkesa të kompanisë amë, dhe falënderoi për vizitën në monitorimin e punimeve në ndërtimin e HC-ve në Deçan.

Z. Krenar Bujupi sqaroi arsyen e ardhjen urgjente në monitorimin e ndërtimit të HC-ve, pasi që në mbledhjen e Bordit të ZRRE-së të datës 15 qershor 2015 është shqyrtuar edhe kërkesa e Shoqërisë KelKos Energy SH.P.K. për zgjatjen e afatit të autorizim final V-402-2012 edhe për një vit, sipas arsyetimit të cekuar në kërkesën përkatëse. Sqaroj se me vendimin përkatës është lëshuar autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për HC Belaja 9.2 MW dhe HC Deçan 8.4 MW, të cilat do të ndërtohen në Lumëbardhin e Deçanit, Komune e Deçanit. Më tej theksoj se vendimi në fjalë është lëshuar për afat dy vjeçar, ku shoqëria ishte e obliguar që brenda kësaj periudhe ti ndërtoj stabilimentet e reja gjeneruese nga uji.

Në bazë të kësaj mund të shifet se afati sipas vendimit për autorizim ka përfunduar, përkundër asaj se me vendimin për autorizim është mundësuar që me kërkesën e palës, mund të vazhdohet vlefshmëria e autorizimit në përputhje me legjislacionin ne fuqi.

Adresa: Rr. Dërvish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org

Shoqërisë KelKos Energy SH.P.K., pas kalimit të afatit për ndërtim nuk ka ushtruar të drejtën edhe për kundër kërkesave nga përfaqësuesit e DLL-së, se duhet të kërkohet shtyrje e tillë, dhe me atë rast kanë kaluar afatet ligjore për realizmin e të drejtës sipas Rregullës për Procedurën e Autorizimit në fuqi në atë kohë. Ka sqaruar se duke parë se ndërtimi i HC-ve, është proces shumë i ndërlikuar dhe kërkon kohë për përfundimin e projekteve të tilla, Bordi i ZRRE-së më datë 11.11.2014 ka amandametuar Rregullën për Procedurën e Autorizimit dhe ka vendor që ndërtimin i kapaciteteve të reja varësisht prej projekteve të zgjatet nga dy vite sa ka qenë më parë është bërë deri në 4 vite për ndërtimin e hidrocentraleve.

Mirëpo ka theksuar se kjo rregull vlen vetëm për të gjithë ata të cilët janë brenda afate të rregullta ligjore, por në rastin konkret është bërë një lëshim ligjor, për parashtrimin e kërkesës për shtyrje të afatit të vendimit për autorizimit final, dhe me këtë rast duhet të gjendet një zgjidhje ligjore, për lejimin e përfundimit të këtyre hidrocentraleve, dhe qëllimi i krejt kësaj vizite është që të kemi një pasqyrë ma të çart rreth realizimit të punimeve dhe kjo të na shërbej për gjetjen e një zgjidhje më të drejtë dhe ma reale.

Z. George Woeber theksoj se arsyeja e mos parashtrimit të kërkesë është se bazuar në Lejen e ndërtimit të Lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor thuhet se fillimin i ndërtimit duhet të bëhet brenda një viti nga data e lëshimit, dhe sa i përket Vendimit për Autorizim është menduar se afati 2 vjeçar nënkupton si datë e fillimit të punimeve e jo si datë brenda së cilës duhet të përfundohet projekti.

KelKos Energy SH.P.K. ka pranuar vendimit për autorizimin final për ndërtimin e HC-ve, në Lumëbardhin e Deçanit, ku do të investon rreth 75 milion Euro, të cilat pas kompletimit të kaskadave do të operojnë bashku me HC Lumëbardhi egzistues. Ndërtimi i këtyre objekteve është bërë në një teren shumë të vështirë në lugina të vogla, shpate të pjerrëta, rrugë shumë të ngushta, vende shkëmbore, ndryshimet klimatike, mungesa të projektimit të objekteve ekzistuese publike dhe pjesërisht brenda zonës së Mbrojtjes Speciale të Manastirit të Deçanit dhe të Zonës së Parkut Nacional.

Gjithashtu ka sqaruar se vendimi V-402-2012 ishte nga fillimi gati e pamundur që të arrihet, por jo për shkak të mungesës së përparimit të punës së KelKos Energy SH.P.K., por për shkak të arsyeve sistematike. Gjatë dy viteve të fundit menaxhmenti i kompanisë ka shpenzuar të gjithë energjinë e saj për të arritur progresin maximal të punimeve të ndërtimit,të cilat mund ti shihni sot edhe në teren. Janë bërë investime të konsideruara në mënyrë që të sigurohet cilësi e lartë e objekteve dhe mbrojtja e furnizimeve lokale me ujë të pijshëm ku janë realizuar investime në sistemin e ujit të Komunës së Deçanit me investime private të investitorit. Ka sqaruar se që nga fillimi janë zhvilluar punimet shtatë ditë në javë, dhe HC Belaja është përfunduar brenda afateve të caktuara nga ZRRE.

Ndërsa punimet e planifikuara për HC Deçan janë shtyrë për shkak të rrëshqitjeve të konsiderueshme të dheut(deri në 25.000 m3 në më shumë se 20 vende), dhe deri 1000 m3 gurë nëntokësor janë dashur të largohen nga rruga e trasesë, po ashta problem dhe vonesa ka shkaktuar edhe ndërtimi i tubacioni të ujit të pijshëm për Komunën e Deçanit i cili ka zgjatur për më shumë se një vit. Kjo ka vonuar punën e ndërtim ndjeshëm.

Ndërtimi i HC Deçan është një dizajnë unik dhe është duke u ndërtuar nëntokë sipas rregullave të MMPH, e cila kërkon masa të veçanta në aspektin e ujëmbledhës dhe stabilimentit të mureve, e cila ka zgjatur edhe periudhën e ndërtimit. Përkundër këtyre sfidave, punimet e ndërtimit të HC Deçan do të përfundojnë në vjeshtën e vitit 2015, për një periudhë totale prej dy viteve nga dita e fillimit të

ndërtimit. Gjithashtu sqaroi se KelKos Energy SH.P.K. është dashur ti kushtoj fokus të veçantë edhe aspektit mjedisor dhe hapësinorë në realizimin e punimeve.

Më tej shtoi se padyshim ishte përgjegjësi e KelKos Energy SH.P.K.. për ndjekjen e procedurave ligjore të ZRRE-së, megjithatë argumentet e cekura dhe ato që do ti shini në teren shpresojmë që do ju japin në pasqyrë më të qartë për sa i përket logjikës së ndërtimeve të projekteve të madhe të ndërtimit, dhe duhet nënvizuar përkushtimin teknik dhe financiar të KelKos Energy SH.P.K., për të përfunduar investimet private në shfrytëzimin e kapaciteteve hidrike në Kosovës. Gjithashtu theksoi se problemet legjislative, për të cilat ZRRE, sigurisht se është e vetëdijshme për projektet e ardhshme dhe do të rezulltoj në mënyrë të drejtë. Në fund theksoj se KelKos Energy SH.P.K. shpreh mirënjohjen e saj për stafin e ZRRE-së, dhe Bordin, të cilat që nga fillimi kanë qenë bashkëpunues dhe kanë dhënë mbështetje të plotë për realizimin e projekteve, dhe kanë shprehur mirëkuptim për nevojat e investitorëve të energjisë.

Më pas është realizuar vizita në teren, ku janë monitoruar punimet në ndërtimin e HC Deçan, traseja e tubacionit, HC Belaja i përfunduar (në proces të testimeve të prodhimit), veprat e marrjes për HC Deçan, grumbullimi i ujërave për të gjitha HC-të nën HC Lumëbardhi ekzistues, si dhe baseni i peshqve me veprën e marrjes për HC-të relevante.

Më poshtë shihni fotot në teren: Ndërtimi i HC Deçan




... turns Water into Power!
www.koessler.com
BELAJE 1 HEPP
Delivery and Erection of
one Francis Turbine
Type: FSHC 12.2V34L
Net head 124.74 m
Speed 600 rpm
Stat. runaway speed 958 rpm
Turbine output 5268 kW
Year of construction: 2014
Serial No.: 005196


... turns Water into Power!
www.koessler.com
BELAJE 2 HEPP
Delivery and Erection of
one Francis Turbine
Type: FSHC 7.5V38L
Net head 127.37 m
Speed 1000 rpm
Stat. runaway speed 1661 rpm
Turbine output 2796 kW

U/min
MW
SYMAP


K+K Energy
Login
Logout
SYSTEM
Alarmlist
Eventlist
Trends
Measurement
Temperatures
Trip Matrix
Auxiliaries
Sequences
UNIT-Controller
Excitation
System
G2

Vepra e marrjes te Lumbardhi ekzistues



Në bazë të asaj që u pa në teren, mund të konkludojmë se punimet në ndërtimin e ndërtesës së HC Deçan me kapacitet prej 8.4 MW, sipas dinamikës së punimeve mund të përfundohen deri në vjeshtën e vitit 2015, pasi që u konstatua se punimet janë duke u realizuar me intensitet jashtëzakonisht të lart. Ndërsa HC Belaja mund të konsiderohet e përfunduar pasi që tani është në fazën testuese dhe shumë shpejt pritet të hyj në prodhim.

Me respekt